



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13, 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) dhe (i) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 04 Qershor 2008, , nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, 14 nenit 21 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, dhe nenit 25 të Rregullorës (QRK) Nr 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2022, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE PËR VENDOSJEN E TRANSFORMATORIT NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim i ipet në shfrytëzim për periudhën afatëgjatë prej 16 vite, toka-Pasuri Shoqërore për Kompaninë për Distribimin dhe Furnizimin me Energji Elektrike (KEDS-it) lidhur me vendosjen e transformatorit 8MVA, 35/(10)20KV për “Prishtina Mall” në pjesën e ngastrës kadastrale P-71409044-00846-9 në vendin e quajtur “ Bezimeni” me sipërfaqe prej 53.5m² (sipërfaqëja totale prej 89888 m²) e evidentuar në Certifikatën 193/22 ZK-Lipjan, P.SH Shkolla Bujqësore Lipjan.

Neni 2

Prona e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, respektivisht sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e transformatorit 8MVA,35/(10)20kv për "Prishtina Mall" i ipet në shfrytëzim KEDS-it me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, përmirësimin e tensionit të rrymës sipas standarteve të parapara teknike, në ndërtimin e linjës së re nëntoksore 10 (20) KV nga TS Lipjan 110/35/10KV deri te qendra tregtare e re "Prishtina Mall".

Neni 3

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës, të cekur në nenin I të këtij propozim-vendimi, është 16 vite, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

Neni 4

Prona e palujtshme e cekur në neni I të këtij propozim-vendimi ipet në shfrytëzim me kompensim, llogaritja e kompensimit për sipërfaqe për m² bëhet për tokën e dhënë në shfrytëzim. Sipërfaqja për m² është 3.50 € në bazë vjetore.

Neni 5

Menyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme do të përcaktohen me kontratë e cila do të lidhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

Neni 6

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër pas marrjes së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parcializimin e sipërfaqës e cila i ipet në shfrytëzim dhe të njejtën t'i regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 16 vite.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në uebfaqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Kompania për Distribimin dhe Furnizimin me Energji Elektrike KEDS ka parashtruar kërkesën 1Nr.353/01-11134 datë 01.03.2022 pranë zyrës së Kryetarit të Komunës, për dhënien në shfrytëzim të një pjese të pronës shoqërore për vendosjen e transformatorit 8MVA, 35/(10)20 KV për “Prishtina Mall” në pjesën ngastrës kadastrale 00846-9 ZK-Lipjan. Në pjesën e ngastrës kadastrale 00846-9 ZK-Lipjan është paraparë ndërtimi i linjës së re nëntoksore 10 (20)KV nga TS Lipjan 110/35/10KV deri te qendra tregtare e re “Prishtina Mall”, në pamundësi të furnizimit me energji elektrike nga objekti aktual, atëherë KEDS-i, i nevojitet vendosja e një transformatori 8MVA,35/(10)20kv jashtë rrethojave të TS-Lipjan 110/35/10KV në kuadër të pjesës së lartcekur. Prandaj duke e pare të nevojshme dhënien në shfrytëzim të pjesës së pronës së lartcekur për qendren tregtare, në mënyrë që t’ju krijohen kushtet për furnizim të energjisë elektrike, në mënyrë që t’ju krijohen kushtet për ushtrimin e veprimtarive të zhvillimit ekonomik, në pajtim të dispozitave të cekura ligjore, kërkoj nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

Shtojcë:

- Kërkesa e KEDS-it, datë 01.03.2022
- Certifikatë/Njësia kadastrale - kopje nga plani
- Orto-foto

01-011/01-14562

Lipjan, më 17 / 03 / 2022

KRYETARI I KOMUNËS
Igri Ahmeti





KOMPANIA KOSOVA E PËR DISTRIBUCION DHE FURNIZIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE
KOSOVIA ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY CO.
KOSO/JSKO PREDAJE IŠTAČENJE ELEKTROENERGIJE
KEDS - SH.A
Nr. 1537 Dt. 03-03-2022
PRISHTINË/A 1

Ndërtesa e Elektrokovës Elektrokovës Building
Bulevardi Bill Clinton nr.3 Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtinë 10000 Prishtina 10 000
Republika e Kosovës Republic of Kosovo

Data	01.03.2022
Për	z.Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
Nga	Alpin Dogan, Kryeshef Ekzekutiv i KEDS Faruk Gjukaj, Drejtor i Investimeve Burbuqe Baruti, Inxhinierë për bashkëpunim me Institucionet Qeveritare
Tema	REVIDIM I KËRKESËS PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËR PARCELËN NR. 00846-9 ZK LIPJAN
Lënda	Vendosja e Transformatorit 8MVA, 35/(10)20kV PËR " PRISHTINA MALL "

Në bazë të Projektit "PRISHTINA MALL" është paraparë ndërtimi i linjës së re nëntokësore 10(20)kV nga TS Lipjani 110/35/10kV e deri te qendra tregtare e re "PRISHTINA MALL". Në pamundësi të furnizimit me energji elektrike të objektit në fjalë nga TS Lipjani 110/35/10kV atëherë KEDS duhet të vendosë një Transformator 8 MVA , 35/(10)20kV jashtë rrethojave të TS Lipjani 110/35/10kV në kuadër të parcelës me nr.00846-9 ZK Lipjan (pronë shoqërore-SH.M.Bujqësore).

Kërkojmë nga titulli i lartëshënuar që të jep lejen e shfrytëzimit të pronës shoqërore në hapësirën prej 53.5[m²] në kuadër të parcelës nr. 00846-9 ZK Lipjan (pronë shoqërore – SH.M.Bujqësore)

Bashkangjitur gjeni:

- ✓ Fletën poseduese dhe kopjet e planit për parcelën nr.00846-9 ZK Lipjan
- ✓ Skica e koordinatave të pikave të rrethojës për transformatorin 8MVA, 35/(10)20kV

Nr. kontaktues: 049-790-341 Burbuqe Baruti (burbuqe.baruti@keds-energy.com)

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:	01.03.2022	
Primljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-353/01-11134		



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-00846-9

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 887/2022

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 17.03.2022 - 08:16

Komuna / Opština / Municipality: LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan / Lipljan / Lypjan

Zyra Kadastrale Komunalne / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-00846-9	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	89888	35-1995 N.FIZ. L. F. 23/13 ndr.f. If.67/2015 ndarje fiz.lf. 6+/2018	23.01.2018	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On
BEZIMENI			23.01.2018

A.2 LLOJJI SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
5	Tokë Ndërtimore/Gradjevinско zemljište/Construction land	Oborr/Dvorište/Back Yard		89888

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH. SHKOLLA BUJQËSORE LIPJAN	KCID1417382	LIPJAN / LIPLJAN / LYPJAN /			1/1	35-1995	23.01.2018

46-9

846-9

